

**UNIVERSITETI I PRISHTINES “HASAN PRISHTINA”**  
**FAKULTETI JURIDIK**  
**DEPARTAMENTI CIVIL**  
**PROGRAMI E DREJTA CIVILE PRONESORE**



**PUNIMI I DIPLOMES MASTER**

**Tema: Fitimi i të drejtës së pronësisë mbi bazën e titullit më të fortë juridik:**  
(puna juridike, parashkrimi fitues, e drejta e trashëgimisë, e drejta e pronësisë së përbashkët  
martesore)

**Mentori**  
**Prof. Dr. Haxhi Gashi**

**Studenti/ja**  
**Denisa Hasanaj**

**Prishtinë, 2024**

## **A B S T R A K T**

Në punim do të flitet për të drejtën e pronësisë në mënyrë të përgjithshme që nga burimi i saj në të drejtën romake, e cila është bazë për të gjitha sistemet e mëvonshme juridike dhe veçanërisht për mënyrat e fitimit të saj. Nisur nga kjo, edhe fitimi i së drejtës së pronësisë trajtohet nga këndvështrimi historik, me përfshirjen e literaturave dhe studimeve të ndryshme, si dhe aspektin ligjor të cilin i'a përkushtojnë kodet civile.

Nga mënyrat për fitim të pronësisë do të nxirren ato më kryesoret dhe më të njohurat. Kryesisht, do të analizohen: puna juridike, parashkrimi fitues, e drejta e trashëgimisë, e drejta e pronësisë së përbashkët bashkëshortore të përkruara nga autorët e konsultuar dhe nga ana tjetër rregullimi të cilin i bëjnë ligjet përkatëse në mënyrë të krahasuar.

Klasifikimi i tyre merr për bazë edhe ndarjen kryesore e cila ka për qëllim të tregojë prejardhjen e pronësisë, burimore ose të derivuara, e me këtë edhe masat e ndërmarra për të arritur qëllimin final të fitimit të së drejtës së pronësisë, në varësi nga kushtet e kërkuara.